



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr.331/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesues, Zyhdi Haziri dhe Adnan Konushevci anëtarë, si dhe me pjesmarrjen e zyrtarit ligjor Ardian Maxhuni, duke vendosur përkritazi me ankesën e organizatës Rjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) dhe INTERNEWS KOSOVA me seli në Prishtinë, dega në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Ferizaj, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me 22.10.2017, mori këtë:

### V E N D I M

**Pranohet** si e bazuar ankesa e organizatës Rjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) dhe INTERNEWS KOSOVA me seli në Prishtinë, subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Ferizaj, dega në Ferizaj, i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 250.00 (*dyqind e pesëdhjetë*) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimi të këtij vendimi **nën kërcënim të përmbarimit**.

### A r s y e t i m

Paneli i PZAP-it, me datën 22.10.2017, ka pranuar një ankesë nga organizata Rjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) dhe INTERNEWS KOSOVA me seli në Prishtinë, me të cilën pretendon se subjekti politik LDK me datë 21.10.2017, në ora 15:22, kanë bërë fushatë zgjedhore duke shpërndarë foto nga faqja e rrjetit social Facebook, me të cilin veprim ka bërë thirrje për ta votuar kandidatin Burim Ugzmajli, për Anëtar të Kuvendit Komunal në Ferizaj nga radhët e subjektit politik LDK. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është thyer heshtja zgjedhore, dhe me këtë veprim është bërë shkelje e dispozitës së nenit 36 paragrafi 1 pika b) e LZP-së.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur një fotografi të printuar lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigje në ankesë të datës 23.10.2017, subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ka theksuar se postimi i publikuar në faqen e rrjetit social Facebook ka qenë më i hershëm dhe se kandidati ynë është deklaruar se nuk e ka pasur të njohur faktin që postimi i mëhershëm mund të konsiderohet si shkelje ligjore dhe nga ky postim nuk mund të vërtetohet saktë koha e rishpërndarjes së këtij postimi. Andaj i ka propozuar PZAP-it që ankesa e ankuesit të refuzohet si e pa bazuar.

Paneli, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoj shkresat e lëndës, në kuptim të dispozitës së nenit 117 paragrafi 2 të LZP-së, konstatoj se:

## **Ankesa është e bazuar**

Paneli pas shqyrtimit të provave, fotos së bashkangjitur në ankesë ka vlerësuar në mënyrë të qartë dhe bindëse se kandidati për anëtar të Kuvendit Komunal në Ferizaj, nga subjekti politik, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Burim Ugzmajli, gjatë heshtjes zgjedhore në rrjetin e tij social Facebook ka bërë fushatë zgjedhore, duke shpërndarë fotografimin e tij me të cilin veprim ka bërë thirrje për ta votuar kandidatin në fjalë.

Andaj Paneli duke marr parasysh këtë si dhe në mbështetje të dispozitave ligjore të LZP-së konstaton se subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), është përgjegjëse për veprimet e saja, pasi që këto veprime paraqesin shkelje të Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike dhe kandidatët, të përcaktuara me nenin 36 paragrafi 1 pika b) e LZP-së, që përcakton se: 24 orë para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës, deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohet bërja fushatë në çfarëdo mënyre.

Paneli në kuptim të nenit 118 pika dhe nenit 120. të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës**

ZL.A.nr. 331/2017 më datën 22.10.2017



**Kryesues i Panelit**  
**Gyltene Sylejmani**

***Këshilla Juridike:*** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par.4 të LZP-së.